[Shqiptarja.com]

E martë 25 Qershor 2024 - Përditësimi i fundit 13:12

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Bleu 8 vota për 40 mijë lekë në 2023, kryetari i zgjedhur i Himarës, Fredi Beleri u zgjodh eurodeputet në Greqi

EURO 2024

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 U kap duke blerë vota, Gjykata e Apelit të Posaçëm lë në fuqi dënimin 2 vite burg për Fredi Belerin

2 Lamtumirë mushkonjës! Ja si t'i largosni dhe të shpëtoni njëherë e mirë

3 Sylvinho pas eliminimit: Dua të pushoj, kemi 5 muaj që punojmë pa ndërprerje! Shqipëritësë i zbulova lojtarë për 10 vitet e ardhshme

4 Zbardhet dosja/Mpeku çoi pacientën e Onkologjikut tek klinika 'Megisi', pazari për operacionin 3 mijë euro! Dëshmitari: Doktori u prish në fytyrë kur refuzova ti bëja kimion mamit

5 Si tentoi Spanja të blinte ndesh/jet kundër Shqipërisë! Prapaskenat e një trukimi

Kronikë

Dhunoi gruan dhe djalin e saj të mitur, pranga 45-vjeçarit në Cërrik! Arrestohet dhe babai i tij, iu gjendën 2 kallëpe tritoli, 1 pushkë, 1 armë gjahu dhe fishekë

Policia e Elbasanit, në kuadër të operacionit 'Risku' në Cërrik, ka arrestuar një 45-vjeçar dhe babanë e tij, pasi dhunoi gruan dhe djalin e saj të mitur. Policia ka sekuestruar 2 kallëpe tritoli, 1 pushkë, 1 armë gjahu dhe fishekë

Redaksia
25 Qershor, 10:32 | **Përditesimi: 25 Qershor, 10:49**

Share

ELBASAN- Babë e bir janë arrestuar nga policia e Cërrikut, duke parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale.

Policia ka arrestuar Vathi Kullolli, 45 vjeç, pasi ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij dhe fëmijës së saj të mitur, si dhe i ka kanosur ata për jetën si dhe babain e tij Zyfer Kullolli, pasi iu gjetën në banesë lëndë plasëse, armë dhe municion.

45-vjeçari u arrestua pas kallëzimit të një shtetaseje se ajo dhe fëmija i saj i mitur, dhunoheshin dhe kanoseshin për jetën, nga bashkëjetuesi i saj.

LEXO EDHE:
Megaoperacioni 'Territor i pastër'/ Policia gjen dhe asgjëson 5396 fidanë dhe bimë kanabis në qarqet Lezhë, Elbasan dhe Shkodër

Gjatë këtij operacioni është vënë në pranga dhe babai i 45-vjeçarit, Zyfer Kullolli, 71 vjeç, pasi nga kontrolli në banesën dhe në automjetin e tij, Policia ka gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale, 2 kallëpe tritoli, 1 armë zjarri pushkë, 1 armë gjahu, municion luftarak dhe 1 mjet prerës (thikë).

Me qëllim trajtimin e plotë të këtij rasti, kallëzueses dhe fëmijës së saj të mitur iu janë plotësuar kërkesëpaditë për urdhra të mbrojtjes së menjëhershme dhe janë dërguar në qendrën sociale "Forumi i Gruas", Elbasan, për të marrë asistencën e nevojshme.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: zyfer kullolli | vathi kullolli | cerrik | Elbasan

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Shqipëria skualifikohet nga Euro 2024, a ju pëlqeu loja e Kombëtares

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Ekzekutimi i ish-oficerit 'Doda' në Elbasan në 2009, identifikohet autori i 5-të i përfshirë në krim (EMRI)
23 Qershor, 08:53

Turizëm dhe traditë! Turi i folkut "ndez" me këngë e valle Elbasanin
Ronaldo Gjoshi
22 Qershor, 15:59

Larg diellit në orët e pikut! Temperaturat e qershorit, përtej normales
Ronaldo Gjoshi
22 Qershor, 15:53

Basha: Nuk i lëmë demokratët në mëshirën e hallit të Berishës! Me çdo kusht do jemi në zgjedhje
21 Qershor, 21:16

Vrasja e Pjerin Xhuvanit, Në Apel gjyqi për Arbër Paplekaj! Prokurori: Qëlloi 7 plumba, avokati: Ishte në kushtet e vetëmbrojtjes
Keti Banushi
21 Qershor, 11:58

Parajsa e trëndafilave në Labinot të Elbasanit (VIDEO)
21 Qershor, 11:13

Elbasan/ Zbulohet baza e armëve në Peqin, pranga anëtarit të një grupi kriminal! I fshihte në ambientet e biznesit (EMRI+ FOTO)
21 Qershor, 09:05

'Kush e solli Doruntinën', kryevepra e Kadaresë vjen ndryshe në Përrenjas
Ronaldo Gjoshi
20 Qershor, 15:13

Karkaleci 'pushton' fushat e Dumresë! Fermerët: Ka bërë namin, dezinsektimi nisi me vonesë!
Ronaldo Gjoshi
17 Qershor, 16:34

Itali-Shqipëri/ Goli i Bajramit elektrizon tifozët kuq e zi në Elbasan (VIDEO)
15 Qershor, 21:53

Prrenjas/ Arrestohet 41-vjeçari, dhunoi punonjësin e shërbimit pyjor! Policia i gjen në shtëpi 400 litra naftë dhe 140 litra vaj lubrifikant kontrabandë
14 Qershor, 16:58

Homazhe për Qazim Sejdinin, Veliaj: Na i bënte më të lehta sfidat, do ta kujtoj për zemrën e bardhë
13 Qershor, 10:57

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje